



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:261888  
Datë: 16.10.2024  
Numri i dokumentit: 06304448

**C-IV-14-7044**

**J H A**, Prishtinë - përfaqësuar nga **Av. F K**, Prishtinë

**Kundër:**

*E paditura*

**Autoriteti i Likuidimit** të NSH. “Ramiz Sadiku” (në Likuidim), **Agjencioni Kosovar i Privatizimit, rr.”** Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese dhe gjyqtarët Bajram Miftari e Diellza Hoxha anëtarë, pas seancës vendimmarrëse, me dt.16 tetor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.REFUZOHET si e pa bazuar** ankesa e ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit( tutje AL) PRN035-0838 i dt. 08.10.2014, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura AKP- Autoriteti i Likuidimit të NSh në likuidim që në emër të kompenzimit për ngastrën kadastrale nr.. në vendin e quajtur “.. “me sipërfaqe 1,80.00 ha, në Prishtinë pronë kjo e marr në mënyrë të kundërligjshme, ta kompensoj në shumën 6,300,000.00 (gjashtë milion e treqind mijë) € nga N.Sh. “Ramiz Sadiku” (në likuidim) në Prishtinë.

**II.VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN035-0838 i dt. 08.10.2014 si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

**III.**Paditësi nuk ngarkohet me taksë shtesë.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 14 nëntor 2014, ankuesi I H A parashtrori në Dhomën e Posaçme padi/ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) të NSh Ramiz Sadiku PRN035-0838 i dt. 08.10.2014 për të drejtën pronësore mbi ngastrën kadastrale nr.. me sipërfaqe 1.80.00 ha, në Prishtinë ose kompensim në shumën 6,300.000.00 (gjashtë milion) € nga N.Sh. “Ramiz Sadiku” (në likuidim).

Ankuesi pretendimet e tij i argumentoi me provat si ne vijim:

1. Autorizimi i parashtruesit të kërkesës i noterizuar me nr. LRP.Nr.20578/13 i dt. 03.12.2013.
2. Dokumenti mbi shpalljen e trashëgimtarëve ligjor të të ndjerit A G A, i noterizuar tek noteri. Me nr. Ref. Nr.LRP,
3. Tapia në gjuhën turke numri serik Nr. 0109554 dhe nr. i regjistrit Y.nr.6010, C.nr.1617, dt. 20 shtator 1929 e noterizuar dhe përkthyer, pasi nuk që ka mund të sigurohet

dokumentacion se pronësia e ngastrës së pretenduar ka qenë e regjistruar në emër të gjyshit, stërgjyshit.

4. Parashtruesi i kërkesës në cilësinë e paditësit të përfaqësuar nga av. A V i cili ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë e cila pastaj është përcjellur në Dhomën e Posacme të Gjykatës Supreme dhe është regjistruar me nr. SCC-06-0110. Me aktvendimin e asaj dhome SCC-06-0110 të dt. 07.12.2006 padia e paditësit kundër të paditurit i bartet për vendosje prap Gjykatës Komunale në Prishtinë. Por pas ndryshimeve ligjore të cilat janë bërë në ndërkohë çështja e paditësit prap i është kthyer në kompetencë DHPGJS-së tani e evidentuar me C-III-14-0152 dhe e pa vendosur .
5. Ekspertizën e ekspertit Sh P të dt. 22.09.2014, i cili në konstatimin dhe mendimin e tij si dhe në skicën e matjeve e ka qartësuar pjesën e ngastrës nr.. në sipërfaqe prej 1,80.00ha. Bazuar në këtë konstatim dhe skicën e matjeve të kësaj ekspertize parashtruesi i kërkesës e përmirëson numrin e ngastrës kadastrale të shënuar në padinë e paditësit , në vendimin e AKP-së të dt. 09.10.2014 se kërkesa e paraqitur nuk ka të bëjë me ngastrën kadastrale Nr., por me ngastrën kadastrale Nr.. Arsyetimi i detajuar është dhënë në konstatimin e kësaj ekspertize.

Me dt.17.10.2014 është dorëzuar me parashtrësë Dokumenti i vitit 1941 me nr. 12219 i dt. 16.09.2014 që ka të bëjë me kërkesën e A I A i cili me dt. 31.07.1941 është i drejtuar Kryetarit të gjyqit të Paqit për kthimin e arës së tij të cilën z. M O ia ka marrë para 20 viteve .

Formulari – Kërkesa për Likudim e dt. 17.07.2007 ku është paraqitur kërkesa prej 6.300.000.00 eurove.

Kërkesat e AKP-së nr. PNR035-0838 të dt. 15.09.2014 dhe 30.09.2014 drejtuar ankuesit për plotësim të kërkesës me prova shtesë .

Vendimi i Autoritetit të likuidimit i dt. 08.10.2014.

Shkresa e dorëzuar në AKP me dt. 17.10.2014 ku i është bashkëngjitur edhe Dëftesa mbi borxhin e bankës hipotekare të Qarkut të Prishtinës nr. 3264.

Mbi këtë bazë paditësi nga provat e lartë shënuara dhe të argumentuara me dokumente të vlefshme pretendon dhe kërkon nga Gjykata në këtë rast, të vërtetoi se, NSh “Ramiz Sadiku” detyrohet ti pranoj apo kompensoj parashtruesit të kërkesës për paluajtshmërinë e pretenduar, andaj, i propozoi gjykatës që Vendimi i AL-së - NSh “Ramiz Sadiku” nr. 13673 të dt. 09.10.2014 të priset si i pa bazuar dhe lënda së bashku me shkresat e bashkëngjitura t’i kthehet AL-së për vlerësimin e kërkesës së parashtruar si të plotë dhe të vlefshme.

Me 09 nëntor 2023, paditësi ka bërë pagesën e taksës gjyqësore.

Me 05 dhjetor 2023 e paditura ka parashtruar mbrojtjen e saj duke theksuar se AL-ja me dt. 08.10.2014, ka refuzuar në tërësi kërkesën e parashtruesit duke u bazuar në nenin 36.2 nënparagrafi 2 i shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP. Sipas mbrojtjes së AKP ankesa është e pa bazuar. Parashtruesi i kërkesës është përgjigjur me dt. 26.09.2014, duke paraqitur disa dokumente një pjesë e të cilave ishin dorëzuar edhe fillimisht, por duke mos arritur dot të tregoj asnjë dokumenti se parashtruesi është i vetmi trashëgimtarë ligjor i gjyshit/stërgjyshit apo që është një ndër trashëgimtarët e tjerë, pastaj nuk ka dorëzuar asnjë provë të dokumentuar se pronësia e ngastrës së pretenduar ka qenë ndonjëherë e regjistruar në emër të gjyshit/stërgjyshit të tij. Së fundmi nuk është dorëzuar asnjë dokument i përditësuar i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës përkatëse në lidhje me historiatin e asetit të pretenduar. Andaj, AL-ja i propozon gjykatës që të refuzohet ankesa si e pa

pranueshme dhe e pa bazuar dhe kërkon që të vërtetohet vendimi i AL-së duke u bazuar në nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me dt. 26.01.2024 në të cilën përfaqësuesi me autorizim i paditësit av.F K gjykatës i dorëzoi provat shtesë si në vijim:

- Aktgjykimin e Gjykatës së Lartë Agrare në Shkup-Rrethi i Graçanicës i dt. 23 prill 1931
- Aktvendimin e Kuvendit Komunal në Prishtinë nr. 05-463-103/49 i dt. 29 nëntor 1949
- Vendimin e komisionit të Kuvendit të qytetit të Prishtinës, për jo kompenzimin e eksproprijimit nr. 05-466-327/50 i dt. 22 mars 1950
- Fleta poseduese e lëshuar nga shërbimi kadastral i palujtshmërive i dt. 20 shtator 1950 njësia organizative 730 nr. 7162,
- Konstatimi i gjeodetit J B dt. 29.11.1950
- Çertifikata e vdekjes së H A,
- Certifikata e lindjes për paditësin J (H) A dhe aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë të lëshuar nga noterja S e K me nr. LPK. Nr. 6822/2017.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën e tij përfundimtare përfaqësuesi ka mbetur në tërësi pranë kërkesës dhe ankesës së parashtruar kundër vendimit të AL-së PRN035-0838 me të cilën ka kërkuar ti njihet e drejta në kompenzim monetar të pronës -ngastrës kad. Nr .. në vendin e quajtur “..“ në sipërfaqe prej 1,80.00 ari, e marr nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, sipas kohës së paraqitjes së kërkesës, pronare e ngastrës NSh “Ramiz Sadiku” në shumën e precizuar prej 6,300.000.00 (gjashtë milion e treqindë mijë euro)€. Përfaqësuesi i ankuesit ka përsëritur pretendimet përkundër faktit se AL-ja ka refuzuar kërkesën në mungesë të provave, duke shtuar se, dy bazat juridike të kontestuara si baza e pronësisë ashtu edhe ajo e legjitimitetit aktiv janë argumentuara me prova të dorëzuara. Ndërsa, sa i përket lartësisë së shumës së kërkuar e paditura asnjëherë nuk e ka kundërshtuar. Meqenëse barra e proves në këtë rast bie mbi të paditurën e cila nuk e argumentoi mënyrën e bartjes së pronës tek NSh Ramiz Sadiku, konsideron se mënyra e fitimit të pronësisë mbi palujtshëmërin është bërë pa bazë juridike dhe në mënyrë të kundërligjshme ngase deri më 20.09.1950 sipas fletës poseduese të lëshuar nga shërbimi kadastral H A. ka qenë pronar i parcelës kad.. Andaj, i ka propozuar gjykatës që ankesa të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet vendimi i kundërshtuar dhe të obligohet e paditura AKP-AL që në emër të kompenzimit për ngastrën kadastrale nr.. me sipërfaqe prej 1,80.00 ari, të kompenzoj në vlerë monetare në shumë prej 6,300,000.00 € me kamatë në lartësi prej 8% nga momenti i paraqitjes së kërkesës deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit si dhe të obligohet e paditura ti paguaj shpenzimet e procedurës të gjitha në shumën prej 2667.5 €.

Edhe përfaqësuesi i AL-së , si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në fjalën përfundimtare mbeti pran pretendimeve të theksuara gjatë seancave si dhe atyre të precizuara me shkrim dhe të dorëzuara në Gjykatë. Tutje ka shtuar se në bazë të parimit juridik se barra e proves (Onus Probandi) bie mbi personin i cili kërkon një të drejtë , ankuesi nuk ka prezentuar prova me të cilat argumenton se është pronar i palujtshmërisë të cilën pretendon. Sipas të paditurës kthimi i pronës nuk është kërkuar brenda afateve ligjore sipas nenit 268 të Ligjit mbi Punën e bashkuar ku parashifet afati prej 5 vitesh e më së voni afati prej 10 vitesh nga i cili ligj vërtetohet se për shkak të skadimit të afateve ligjore , nuk është e mundur të kërkohej kthimi i palujtshmërisë. Ndërsa, sipas Ligjit mbi Mardhënjet Themelore Juridike Pronësore është përcaktuar se me kalimin e pronës në pronësi shoqërore, pronari i mëparshëm e humb pronësin mbi sendin –pronën. Në fund konsideron se pretendimet e paraqitura të ankuesit nuk janë të bazuara në asnjë dëshmi apo fakt material, të cilat do të gjenin mbështetje në dispozita ligjore, prandaj mungesat e tilla e bëjnë padinë të padëndrueshme. Andaj, AL në emër të AKP-së si përfaqësuese e NSh Ramiz Sadiku i propozoi gjykatës të vërtetoj vendimin e Autoritetit të likuidimit dhe ta hedhë poshtë si të pa bazuar ankesën .

### Arsyetim ligjor

Ankesa e ushtruar ndaj vendimit të AL-së është në tërësi e pabazuar.  
Refuzimi i ankesës është bërë për shkaqet si në vijim;

Ngase pala ankuese me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se për pronën të cilën pretendon se i është eksproprijuar në vitin 1950 nga Sekretariati i Financave të Qytetit të Prishtinës me qëllim të ndërtimit të objekteve të standardit shoqëror dhe dhënjes në shfrytëzim për organizatat shtetërore, me vendimin e dt. 22 mars 1950 nuk kishte ushtruar për ta kundërshtuar vendimin si të tillë .

Pastaj nga shkresat e lëndës rezulton se, nga kjo kohë nuk është vërtetuar me asnjë provë se pala paditëse ka tentuar që të kthej pronën e tij në pronësi për ta evidentuar të njëjtën në regjistrin kadastral që është detyrim ligjor bazuar në dispozitën e nenit 124 paragrafi 1 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera sendore të Kosovës nr. 03/L-154 i cili parashef se *“Në qoftëse një e drejtë sendore është regjistruar në Regjistrin e të drejtave në palujtshmëritë, prezumohet se ajo e drejtë i takon atij për të cilin është regjistruar”* ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni parashef se *“Në qoftëse një e drejtë është shlyer nga regjistri i të drejtave në palujtshmëri, prezumohet se ajo e drejtë nuk ekziston”*. Pra derisa nuk ekziston baza juridike për një të drejtë pronësore të pretenduar atëherë, edhe kërkesa për kompensim monetar është e pabazuar.

Në rastin konkret ankuesi këto veprime i kishte ndërmarr vetëm me vitin 2006 kur kishte ushtruar padi pran Kolegjit të Veçant të Gjykatës Supreme të Kosovës e evidentuar me nr. SCC-06-0110 .

Poashtu, pas hyrjes në likuidim të NSh “Ramiz Sadiku” në vitin 2007 ankuesi kishte paraqitur kërkesë në afatin ligjor në Autoritetit të Likuidimit dhe për kërkesën e tij AL-ja me dt. 16.09.2014 kishte kërkuar nga ankuesi informata shtesë por, në përgjegjen e dt.26.09.2014 ai kishte dorëzuar dokumentacionin e prezentuar edhe më parë, e jo provat e kërkuara nga AL-ja.

Mbi bazën e këtyre të gjeturave kërkesa e ankuesit ishte refuzuar në mungesë të dokumentacionit të kërkuar për të vërtetuar legjitimitetin aktiv të palës respektivisht vendimin noterial mbi shpalljen e trashëgimtarëve ligjor të të ndjerit A G Aga, dokumentit të përditësuar të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës përkatëse, në lidhje me historiatin e asetit të pretenduar kopje e vlefshme e kërkesës, për pretendimin e bartjes së asetit në organet kompetente edhe më parë si dhe dokumenti i vlefshëm dhe qartësisht i lexueshëm i vitit 1941 mbi marrjen e ngastrës së pretenduar nga ana e organeve të atëhershme të pushtetit.

Përfaqësuesi i ankuesit në seancë gjyqësore ka prezentuar prova shtesë dhe nga Aktvendimi i trashëgimisë me nr. Ref. i dt. i lëshuar nga noterja S K vërtetohet se, trashëgimtarë i vetëm ligjor i H A është tani ankuesi J (H) A. Nga kjo rezulton se, pretendimi i të paditurës se ankuesi nuk ka dëshmuar me prova se është trashëgimtar ligjor i tani të ndjerit H A, nuk qëndron . Poashtu, pretendimi i të paditurës se ankuesi nuk ka dorëzuar dokument të vlefshëm dhe qartësisht të lexueshëm të vitit 1941 për marrjen e ngastrës së pretenduar nga ana e organeve të atëherëshme në pushtet, është i pabazuar ngase paditësi i dorëzoi gjykatës dokumentin në origjinal dhe në përkthim –të noterizuar ku vërtetohet se me dt. 29 nëntor 1949 kuvendi Komunal i Qytetit të Prishtinës kishte marr vendimin nr. 05-463-103/49 me të cilin ish-in eksproprijuar në favor të Kuvendit të Qytetit të Prishtinës pronat e 15 qytetarëve – nën numrin 5 ishte edhe këtu trashëgimlënësi i ankuesit H (J) A, shpronësim ky që ishte bërë me qëllim të formimit të blloqeve tokësore dhe shfrytëzimit proporcional të tokës bujqësore në rajonin e Qytetit të Prishtinës .

Ndërsa, nga Sekretariati i Financave i Kuvendit të Qytetit të Prishtinës me aktvendimin nr. 05-466-327/50 të dt. 22 mars 1950 ishte konstatuar se eksproprijimi–arondimi i tokës së pronarit H I A sipas fletës poseduese ., ishte i domosdoshëm për zhvillim të standardit shoqëror dhe ndërtim të objekteve kolektive. Pronari i kësaj toke H I A kishte kërkuar që për tokën e shpronësuar ti ndahet ndonjë tokë në vend tjetër duke refuzuar kompenzimin monetar. Në seancën e caktuar i njëjti nuk i ishte përgjegjur ftesës e as nuk kishte ushtruar ankesë ndaj këtij vendimi.

Nga të cekurat më lartë nuk është kontestues fakti se deri me dt.22 mars 1950 pronar i paluajtshmërisë sipas fletës poseduese nr.. ishte H I A- trashëgimlënësi i këtu ankuesit, e cila pronë me vendimin e organeve komunale i është eksproprijuar –shpronësuar. Këtë e vërtetojnë edhe konstatimet – gjetjet e ekspertit të gjeodetit J B I A e dt. 24 nëntor 1950 .Tutje, nuk kontestohet as fakti se që nga kjo kohë as trashëgimlënësi e as trashëgimtarët nuk kanë ndërmarr asnjë veprim në drejtim të atakimit-kundërshtimit të vendimit apo vërtetimit se prona e shpronësuar nuk është kompenzuar me pronë tjetër ndërsa, kompenzimin monetar tashëgimlënësi me kohë e kishte refuzuar. Andaj, kërkesa e tani ankuesit për kompenzim në të holla për tokën e eksproprijuar është e ushtruar vetëm atëherë kur në vitin 2007 NSh “Ramiz Sadiku” kishte hyr në likuidim ndërsa, ankuesi me dt.29.12.2014 ushtroi kërkesë në Agjencionin Kosovar të Privatizimit për njohjen e pronësisë për ngastrën kadastrale Nr.. me sipërfaqe prej 1,80.00 ha ose kompenzimin në shumë prej 6,000.000.00 €, e që shprehur ndryshe i bie 64 vite pas marrjes së vendimit për eksproprijim.

Duke u bazuar dispozitat Ligjit mbi Punën e Bashkuar ligjore neni 268 parashef se “ *Po qe se patundshmëria është bërë pronësi shoqërore pa bazë juridike, kthimi i së njëjtës mundet të kërkohej në afat prej 5 vitesh, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni por, më së voni në nafat prej 10 vitesh*“, gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka respektuar afatet ligjore për realizimin e të drejtës së pretenduar.

Në këtë rast Ndërmarrjes shoqërore si zotëruese e pronës së paluajtshme, duhet ti ofrohet siguri juridike që një e drejtë e cila nuk është kontestuar për kaq shumë vite, të mbetet e pandryshuar. Ky stabilitet i të drejtave pronësore meriton mbrojtje nga Gjykata.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Bazuar në dispozitën e nenit 62 paragrafi 3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.06/L-086 secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në afatin kohor prej 15 ditëve, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

**Hajrie Shala**, Gjyqtare kryesuese \_\_\_\_\_  
**Bajram Miftari**, Gjyqtar \_\_\_\_\_  
**Diellza Hoxha**, Gjyqtare \_\_\_\_\_